

VENDIM
Nr.544, datë 1.5.2008

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.27, DATË 19.1.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË VLERËSIMIT DHE TË DHËNIES
SË KONCESIONEVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 5 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006, “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të nënndarjes “i” të pikës 1 të kreut V “Udhëzime për mënyrën e zbatimit të procedurave konkurruese” të vendimit nr.27, datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Në rastin kur objekti i kontratës së koncesionit është ndërtimi i hidrocentraleve, kontrata e përdorur do të jetë e formës “BOT”, që do të thotë ndërtim, operim dhe transferim i së drejtës së pronësisë dhe operimit, në përfundim të kontratës së koncesionit.

Me kërkesë të koncesionarëve, autoriteti kontraktor ka të drejtë t’i negociojë kontratat e lidhura të koncesionit, për reflektimin e konceptit BOT, të parashikuar në paragrafin e mësipërm.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e tij edhe për procedurat e garave, për të cilat nuk janë nënshkruar kontratat e koncesionit.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha